




Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Universitetit Metropolitan të Tiranës
Korrik 2017**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1 Janthia Taylor Kryetare



2 Diturije Ismaili Anëtare



3 Kevin Kendall Anëtar



Datë: 6-7 korrik 2017

Përmbajtja

Përmbajtja.....	3
Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	5
Raporti i detajuar.....	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	11
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	15
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	19
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	23
Lista e dokumenteve	27

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga APAAL-i. Grupi i vlerësimit drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre.

Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjyimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti Metropolitan i Tiranës (institucioni), i cili u themelua zyrtarisht në maj të vitit 2010, është një kolegji i ri universitar i arsimit të lartë, që përbëhet nga dy fakultete të vendosur në tre ndërtesa moderne në Tiranë.

Misioni i institucionit është: është përgatitja e drejtuesve të rinj të biznesit shqiptar dhe specialistëve të lartë në fushën e inxhinierisë, arkitekturës, ekonomisë dhe teknologjisë së informacionit, të aftë për të punuar si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë rajonal dhe evropian.

“Misioni do të përmbushet nëpërmjet: formimit të specialistëve të kualifikuar për sektorin shqiptar të biznesit; ofrimit të mundësive për të diplomuarit për të nxënëit gjatë gjithë jetës dhe mundësinë e kërkimit shkencor me anë të botimeve; përmirësimit të vazhdueshëm të programeve akademike mbështetur në modelet më të mira ndërkombëtare; investimit në kërkimin shkencor; ofrimit të një ambienti cilësor për të nxënëit dhe përvojën e studentëve.”

Këshilli i Ministrave, në tetor të vitit 2011 e autorizoi institucionin për ofrimin e katër programeve të ciklit të parë: Inxhinieri Ndërtimi dhe Inxhinieri Kompjuterike në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Shkencave të Aplikuara; dhe Menaxhim Biznesi dhe Informatikë Ekonomike në Fakultetin e Ekonomisë. Për t'i pasuruar këto disiplina, institucioni paraqiti fillimisht programet e nivelit Master, gjatë vitit akademik 2013-2014. Në kohën e realizimit të vlerësimit të jashtëm, institucioni ofronte pesë programe të nivelit Bachelor dhe tetë programe të nivelit Master, si edhe një program të ri të integruar në Arkitekturë, që do të fillonte në shtator të vitit 2017.

Të gjitha programet janë me kohë të plotë; në programet e nivelit Bachelor ishin të regjistruar 513 studentë, ndërsa në programet e nivelit Master ishin 211 studentë. Numri i studentëve thuhet se është dyfishuar që prej vitit akademik 2014-2015 dhe shumica e tyre janë me shtetësi shqiptare, ndërsa rreth një për qind vijnë nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia. Deri më sot janë diplomuar 289 studentë. Institucioni ka 51 anëtarë të stafit akademik të brendshëm, 47 të jashtëm dhe 20 anëtarë të personelit administrativ.

Një nga tiparet e institucionit është bashkëpunimi i ngushtë me filialet e shoqërisë themeluese të saj, në veçanti “Metropolitan Inkubator”, inkubatori i parë i sipërmarrjes në Shqipëri brenda kampusit të universitetit.

Institucioni po ndërton një kampus të ri pranë Liqenit Artificial të Tiranës dhe ka plane të zhvendoset në ambientet e reja në shtator të vitit 2018.

Raport i përmbledhur

Një grup i vetëvlerësimit koordinoi përgatitjen e Raportit të Vetëvlerësimit të institucionit. Grupi përbëhej nga përfaqësues të drejtuesve të lartë nga të dy fakultetet, nga administrata, nga njësia e sigurimit të cilësisë dhe nga studentët. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm organizoi takime me anëtarë të stafit akademik dhe të stafit mbështetës, për të mbledhur informacionin e kërkuar.

Dokumentet e shqyrtuara përfshinin një sërë referencash, që iu bashkëngjitën raportit përfundimtar të vetëvlerësimit. Një projektraport u shpërnda në nivele të ndryshme të institucionit, përpara se versioni përfundimtar të përmbylej dhe të miratohej nga Rektori. Institucioni bashkëpunoi plotësisht gjatë procesit të vlerësimit. Dokumentacioni u vu në dispozicion në gjuhën angleze, dhe u sigurua dokumentacion shtesë sipas kërkesës.

Vizita u krye gjatë dy ditëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë, nga personeli i institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe mbajtësi i shënimeve, të caktuar nga APAAL-i, agjencia përgjegjëse për vlerësimet e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet shtesë të kërkuara. Gjithsej, u morën në konsideratë 143 dokumente, të cilat e ndihmuan Grupin e Vlerësimit të Jashtëm të njihet me strukturën, politikën dhe procedurat e menaxhimit, dhe me mënyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore.

Dokumentet e shqyrtuara përfshinin: Statutin e Institucionit; Rregulloren e Brendshme (rregulloret akademike); Strategjia e Zhvillimit; raportet vjetore; marrëveshjet e bashkëpunimit; manualët e studentëve; procedurat e pranimit dhe orientimit të studentëve; shembuj të informacionit për programet; dhe procesverbale nga mbledhjet vendimmarrëse.

Gjatë dy ditëve të vizitës së vlerësimit u organizuan një sërë takimesh, që i mundësuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të kuptojë më qartë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e stafit dhe studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektoren, Grupin e Vetëvlerësimit, Administratorin, dekanët e fakulteteve, përgjegjësit e departamenteve, studentët, stafin akademik, administrativ dhe mbështetës, dhe disa punëdhënës, partnerë dhe alumni.

Gjatë të gjitha takimeve u mbajtën shënime. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, si pjesë të vizitës në kampus vizitoi bibliotekën, laboratorët e inxhinierisë së ndërtimit, inxhinierisë elektronike dhe kompjuterike, "Metropolitan Inkubator", auditorët, Zyrën e Këshillimit të Karrierës, zyrat e stafit, arkivin dhe kafenetë e studentëve. Pas vlerësimit të të gjitha dokumenteve të vëna në dispozicion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti përfundimet e renditura më poshtë.

Institucioni i përmbush plotësisht standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij. Ai ka një Statut të publikuar, që përcakton misionin, objektivat, statusin ligjor dhe organizimin e menaxhimit të institucionit, në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë në Shqipëri. Në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit, institucioni synon marrëdhënie bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, duke mundësuar në këtë mënyrë mobilitetin e stafit dhe studentëve.

Ndonëse kjo veprimtari partneriteti mbështet vazhdimisht stafin, ende nuk ka ndikuar në mobilitetin e Studentëve. Rrjedhimisht, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se institucioni po bën përpjekje për të mundësuar mobilitetin e studentëve në nivel ndërkombëtar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, nuk identifikoi dobësi dhe nuk dha rekomandime për këtë Fushë Vlerësimi.

Institucioni përmbush kryesisht standardet për Burimet. Institucioni ka një politikë të përshtatshme të burimeve njerëzore. Përgjegjësia për buxhetimin dhe menaxhimin e burimeve parashikohet në Statutin e institucionit. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy dobësi: së pari, mungesa e stokut më gjithëpërfshirës të bibliotekës, për të mbështetur veprimtarinë kërkimore të studentëve dhe stafit, duke marrë parasysh faktin se numri i studentëve është dyfishuar që prej vitit akademik 2014-2015 dhe përkushtimin e madh ndaj kërkimit shkencor. Rekomandohet që institucioni të rishikojë stokun e librave në bibliotekë, për të siguruar përmbushjen e nevojave të studentëve dhe stafit. Përbën dobësi, mungesa e ofrimit të aksesit gjithëpërfshirës në burimet e të nxënit, personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që institucioni të marrë masa në mënyrë urgjente, për të siguruar aksesin e personave me aftësi të kufizuara. Institucioni ka filluar trajtimin e çështjes së zgjerimit të gamës së shërbimeve të bibliotekës, teksa numri i Studentëve që përdorin burimet online, është në rritje. Rrjedhimisht, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon shërbimin e burimeve të bibliotekës online “McGraw Hill”.

Institucioni i përmbush plotësisht standardet për Kurrikulën. Programet e institucionit pasqyrojnë në mënyrë të përshtatshme Misionin dhe Strategjinë e Zhvillimit, me përqendrim të veçantë në përmbushjen e nevojave teknike dhe ekonomike. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë: specifikimet e detajuara të moduleve, që iu mundësojnë studentëve të përvetësojnë aftësi inxhinierike dhe sipërmarrjeje në Shqipëri, në përputhje me strategjinë e institucionit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi dobësi dhe nuk dha rekomandime për këtë Fushë Vlerësimi. Megjithatë, ai pohoi një veprim të ndërmarrë: përdorimi i modulit “Gjuhë angleze”, që nxit mobilitetin e studentëve dhe i mundëson ata të përfitojnë nga botimet ndërkombëtare.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy karakteristika të praktikës së mirë: së pari, mbështetja për komercializimin e teknologjisë së inovacionit, të zhvilluar nga inkubatori i biznesit të institucionit, që mundëson transferimin e njohurive; dhe së dyti, bashkëpunimi i mirëstrukturuar i institucionit për zhvillimin dhe përdorimin e pajisjes CPT, që mundësoi krijimin e lidhjeve të forta me bizneset vendase, zhvillimin e kërkimit bazuar në praktikë për stafin dhe studentët, dhe përparimin e axhendës kërkimore të institucionit si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk dha rekomandime. Programet e studimit janë të përshtatshme, zhvillohen në mënyrë të efektshme dhe i nënshtrohen përmirësimeve të vazhdueshme për rritjen e cilësisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi një veprim të ndërmarrë nga institucioni. Kjo lidhet me politikën e institucionit për të investuar në stafin akademik që ka punuar jashtë shtetit për arsye kërkimore ose trajnimi, duke mbështetur në këtë mënyrë ndërkombëtarizimin institucional.

Universiteti përmbush plotësisht standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, nuk identifikoi ndonjë dobësi, nuk dha rekomandime dhe nuk bëri pohime. Ai arriti në përfundimin se institucioni ndjek politika të përshtatshme për pranimet e studentëve të rinj, orientimin dhe mentorimin, komunikimin me studentët dhe stafin, mbështetjen e kategorive të veçanta shoqërore (me përjashtim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, siç identifikohet në fushën “Burimet”), literaturën (me përjashtim të stokut të librave identifikuar nën fushën “Burimet”) dhe mbështetjen për studentët gjatë gjithë karrierës së tyre akademike, kulturore dhe sportive në institucion.

Institucioni ndërmori vetëvlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm verifikon nivelin e angazhimit të institucionit në procesin dhe bashkëpunimin e tij me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- specifikimet e detajuara të moduleve, që iu mundësojnë studentëve në Shqipëri të përvetësojnë aftësi inxhinierike dhe sipërmarrjeje, në përputhje me strategjinë e institucionit (pika 3.6; **Kapitulli I, Standardi I.4**)
- mbështetja për komercializimin e teknologjisë së inovacionit, e siguar nëpërmjet inkubatorit të biznesit të institucionit, që mundëson transferimin e njohurive (pika 4.6; **Kapitulli II, Standardi I.2**)
- bashkëpunimi i mirëstrukturuar i institucionit për zhvillimin dhe përdorimin e pajisjes CPT, që ka mundësuar krijimin e lidhjeve të forta me bizneset e vendit, zhvillimin e kërkimit bazuar në praktikë, si për stafin, ashtu edhe për studentët, dhe përparimin e axhendës së veprimtarisë kërkimore të institucionit, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar (pika 4.9; **Kapitulli II, Standardi I.6**)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e shërbimeve të gjera të bibliotekës, në mbështetje të veprimtarisë kërkimore të studentëve dhe stafit (pika 2.10; **Kapitulli III, Standardi V.1**)
- mungesa e ofrimit të aksesit gjithëpërfshirës në burimet e të nxënies personave me aftësi të kufizuara (pika 2.11; **Kapitulli III, Standardi VII.4**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- të rishikojë stokun e librave të bibliotekës, për të siguruar se ajo i përmbush nevojat e studentëve dhe stafit (pika 2.10; **Kapitulli III, Standardi V.1**)
- të marrë hapa për të siguruar aksesin në ambiente të personave me aftësi të kufizuara (pika 2.11; **Kapitulli III, Standardi VII.4**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- përpjekjet e bëra nga institucioni për të mundësuar mobilitetin e studentëve në nivel ndërkombëtar (pika 1.9; **Kapitulli III, Standardi III.4**)
- shërbimet në rritje të burimeve të bibliotekës online “McGraw Hill” (pika 2.10; **Kapitulli III, Standardi V.1**)
- zhvillimi i modulit “Gjuhë angleze”, që nxit mobilitetin e studentëve dhe iu mundëson atyre që të përfitojnë nga botimet ndërkombëtare (pika 3.6; **Kapitulli I, Standardi I.4**)
- politika e institucionit për të investuar te stafi akademik që ka punuar jashtë shtetit për arsye kërkimore ose trajnimi, duke mbështetur në këtë mënyrë ndërkombëtarizimin institucional (pika 4.7; **Kapitulli II, Standardi I.3**).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht.**
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënien, të Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjes për ta **përbushen plotësisht.**

Gjykim i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit se në Universitetin Metropolitan të Tiranës, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur plotësisht.**

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Bordi i Lartë Drejtues i institucionit miratoi Statutin në shkurt të vitit 2013 [A3], pasi miratimit paraprak nga Senati Akademik. Statuti i nënshtrohet ndryshimeve të herëpashershme: për shembull, në kohën e realizimit të vlerësimit, institucioni ishte në pritje të miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të një ndryshimi të miratuar në Bordin e Lartë Drejtues, në janar të vitit 2017, ku parashikohej themelimi i institucionit si një universitetit. [A8] Statuti është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë për institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë [A1] Statuti [A3] përcakton misionin, organizimin dhe veprimtarinë e institucionit, duke përfshirë funksionimin e komisioneve, llojet e programeve të ofruara, të drejtat dhe detyrimet e studentëve dhe rekrutimin e stafit. Ndonëse Institucioni përcaktohet si një institucion jopublik i arsimit të lartë që ofron programe të nivelit Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave dhe doktoraturë, [A3] në kohën e realizimit të vlerësimit, programet e doktoraturës ishin ende në zhvillim. Rregullorja e Brendshme e institucionit [A6] miratohet nga Senati dhe ofron më shumë detaje, veçanërisht në lidhje me programet dhe organizimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit. Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me Statutin e tij. [A3; M1a; M1b; M2; M3; M4; M5; M6; M7] **[Kapitulli III, Standardi I.1]**

1.2 Institucioni organizohet për të garantuar efektshmërinë e menaxhimit, në përputhje me Statutin [A3] dhe Rregulloren e Brendshme. [A6] Siç pasqyrohet edhe në organigramë, [A3 fq. 6] institucioni përbëhet nga fakultetet, departamentet dhe njësitë mbështetëse administrative; kjo strukturë siguron ndarjen e funksioneve akademike dhe administrative. Statuti përcakton marrëdhënien ndërmjet shoqërisë themeluese dhe strukturave institucionale, duke përfshirë autonominë e secilit subjekt dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive. [A3] Në Statut përcaktohen edhe rolet e Bordit të Lartë Drejtues, Senatit Akademik, Këshillit të Fakultetit, Këshillit të Etikës, Këshillit të Sigurimit të Cilësisë, Rektorit, Administratorit, dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve. Drejtimi i institucionit ndjek një qasje konsultative, ku propozimet bëhen në nivel departamenti: për shembull, buxhetet e propozuara për departamentet merren parasysh gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor, përpara se të miratohen nga Senati Akademik dhe, në fund, nga Bordi i Lartë Drejtues. [M7] Rrjedha e informacionit nga stafi në Senat, nëpërmjet departamenteve, dhe qarkullimi i vendimeve të marra nga Senati drejt stafit dhe studentëve është e efektshme. [M1a; M1b; M2; M3; M4; M6; M7] Menaxhimi dhe administrimi i institucionit dhe proceset vendimmarrëse funksionojnë në mënyrë të përshtatshme dhe janë të kuptueshme nga stafi i të gjitha niveleve. [M2; M5; M6] **[Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi II.3]**

1.3 Mbledhjet e Senatit Akademik, Bordit të Lartë Drejtues dhe departamenteve, realizohen në mënyrë periodike dhe përfshijnë një axhendë dhe shkresa mbështetëse. [B29; B30; B31; B32; B33; B34] Stafi vihet në dijeni të vendimeve, si nëpërmjet përfaqësimit të stafit, faqes së internetit dhe intranetit, ashtu edhe nëpërmjet adresës së emailit. Stafi ka akses në informacionin konfidencial të portalit me anë të një fjalëkalimi. [M2] Rolet dhe përgjegjësit e stafit kyç në institucion, për shembull të dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve, përcaktohen në Statut [A3] dhe në Rregulloren e Brendshme. [A6] Stafi që u takua me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm [M1b; M2; M5; M6] u shpreh se atyre iu jepet informacion dhe përfshihen në procesin e vendimmarrjes. Struktura e menaxhimit funksionon me efektshmëri dhe efikasitet, duke nxitur në këtë mënyrë debatin konstruktiv. **[Kapitulli III, Standardi I.3]**

1.4 Institucioni sigurohet që të respektohen kufijtë e autonomisë së tij dhe që ta ushtrojë autonominë e tij brenda kufizimeve të legjislacionit dhe Rregullores së tij të Brendshme. Këshilli i Vlerësimit të Cilësisë [A9] verifikon administrimin e institucionit dhe

veprimtaritë e tij dhe është përgjegjës për përmbushjen e Standardeve Shtetërore të Cilësisë në nivel institucional. Ai përgatit Raportin Vjetor, që përcakton veprimtaritë vjetore, **[A12; M2]** për rektorin dhe Senatin. Institucioni ka një zyrë për Marrëdhëniet me Jashtë **[A3; M6]**, për të lehtësuar aksesin në financim nga programet e disponueshme evropiane. Ai ka përfshirë gjithashtu ekspertë të jashtëm në hartimin e programeve të studimit dhe përditësimin e atyre ekzistuese, në inxhinierinë elektrike dhe elektronike. **[A11]** **[Kapitulli III, Standardi I.4]**

1.5 Institucioni ka një Strategji të Zhvillimit, **[A4]** të miratuar nga Senati Akademik, **[A5]** që përcakton misionin për t'i përgatitur profesionistët që të punojnë në fushat përkatëse ekonomike dhe teknologjike, për të angazhuar stafin më të mirë akademik në mësimdhënie dhe veprimtari kërkimore. Ai, gjithashtu rendit objektivat strategjike afatmesme dhe afatgjata. **[A4]** Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, nëpërmjet takimeve me stafin **[M1a; M1b; M2; M5; M6]** vuri re se i gjithë stafi u angazhua në këtë proces, duke filluar nga departamentet e deri te Senati dhe Bordi i Lartë Drejtues. Institucioni e përmbush misionin dhe qëllimin e tij në fushat e ekonomisë dhe inxhinierisë. **[Kapitulli III, Standardi I.5]**

1.6 Institucioni përgatit Raportin Vjetor **[A1; A12]** për veprimtarinë akademike, kërkimore dhe financiare dhe e dorëzon atë në Ministri, sipas legjisllacionit në fuqi. Raporti përgatitet me ndihmën e njësive akademike dhe administrative në lidhje me përmbushjen e misionit të institucionit dhe objektivave strategjike. Ai miratohet nga Senati Akademik përpara se të dorëzohet në Ministri. Raportet janë të disponueshme për stafin dhe studentët, në Sekretariatë Mësimore ose në portalin e stafit. **[M5; M6]** **[Kapitulli III, Standardi I.6]**

1.7 Institucioni përbëhet nga dy fakultete, të cilët ndahen në dy departamente dhe kanë një qendër kërkimore: Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave të Aplikuara; Departamentet e Menaxhim Biznesit, Inxhinierisë së Ndërtimit, Inxhinierisë Kompjuterike dhe Informatikës Ekonomike. **[A1; A3]** Kjo strukturë përputhet me kërkesat ligjore dhe Statutin **[A3]** dhe përmbush standardet ligjore lidhur me numrin e stafit dhe studentëve, kapacitetin dhe infrastrukturën institucionale dhe kualifikimet e stafit. **[A14]** Institucioni ka autonomi të plotë dhe liri akademike në mësimdhënie dhe kërkimin akademik, në përputhje me nenin 13 të Statutit të tij. **[A3]** Kjo përfshin liri për të përzgjedhur stafin e tij, për të ofruar programe studimi, për të krijuar lidhje bashkëpunuese me universitete dhe kolegje të tjera, për të pranuar studentë dhe për të menaxhuar burimet në pronësi të ligjshme të institucionit. Struktura institucionale organizohet në njësi mësimdhënie dhe kërkimi, që mbështeten nga organet administrative. **[A3; M6]** Programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga institucioni, menaxhohen nga departamentet dhe fakultetet përkatëse, **[M1a; M1b; M2; M3; M5; M6]** dhe publikohen në faqen e internetit të institucionit, **[http://umt.edu.al/new/]** që mundësohet si në shqip, ashtu edhe në anglisht. **[Kapitulli III, Standardi II.1]**

1.8 Institucioni profilizohet posaçërisht në ekonomi dhe inxhinieri dhe kryen studime periodike të tregut të punës në këto fusha; **[A1]** një shembull i tillë është studimi i kohëve të fundit të tregut në përgatitje të hapjes së një programi të ri Master në Arkitekturë. **[A19]** Institucioni ka një Zyrë Këshillimi të Karrierës, **[A1; M6]** që mban kontakte me një numër të madh punëdhënësish dhe me Zyrën e Punësimit. Zyra iu ofron këshillim studentëve për mundësitë e punësimit dhe organizon aktivitete, siç janë panairët vjetore të karrierës, **[A21]** që u krijojnë studentëve kontakte me punëdhënësit. **[M6]** Zyra e Këshillimit të Karrierës monitoron punësimin e të diplomuarve **[A22]** nga institucioni dhe i këshillon ata që të gjejnë vende pune në përputhje me studimet e tyre. **[B7; M6]** Programet e ofruara nga institucioni publikohen në faqen e internetit dhe, rrjedhimisht, janë të disponueshme për publikun e gjerë. **[http://en.umt.edu.al/]** **[Kapitulli III, Standardi III.1]**

1.9 Strategjia e Zhvillimit përcakton prioritetet institucionale **[A4]** në lidhje me bashkëpunimin me partnerët, që rezulton në pjesëmarrjen në një sërë veprimtarish me partnerë shqiptarë dhe të huaj. **[A13; A23; A28]** Institucioni ka gjithashtu dy programe të

formimit në edukimin në vazhdim: Vlerësimi dhe Investimi në Pasuritë e Paluajtshme; [A24] dhe Menaxhimi i Projekteve në nivel Evropian. [A25] Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me një sërë institucionesh të arsimit të lartë si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë shtetit, [A26] dhe ka një numër të konsiderueshëm lektorësh të huaj të ftuar. [A13; A30; A31] Disa anëtarë të stafit akademik ekzistues janë arsimuar në universitete të huaja [A37] dhe institucioni aspiron të marrë financim nëpërmjet programit Erasmus, për të nxitur shkëmbimet, që ende janë në faza të hershme zhvillimi. [A29] Megjithëse Anketimi i stafit akademik [Q3] konstatoi se 31.58 për qind e pedagogëve kishin studiuar jashtë vendit në pesë vitet e fundit, anketimi përkatës i studentëve [Q7] konstatoi se 98.08 për qind e studentëve nuk kishin studiuar jashtë vendit. Rrjedhimisht, institucioni ndjek një strategji bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe ka një strategji bashkëpunimi me institucione mbështetëse. Ai ka një politikë të favorshme edhe ndaj mobilitetit të stafit akademik edhe studentëve në nivel ndërkombëtar, por nuk ka pasur ndikim të rëndësishëm në mobilitetin e studentëve. [Anketimi i studentëve Q7; M3; M5] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** se institucioni po bën përpjekje për të mundësuar mobilitetin e studentëve në nivel ndërkombëtar. [*Kapitulli III, Standardi III.2, Kapitulli III, Standardi III.3, Kapitulli III, Standardi III.4*]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- përpjekjet e bëra nga institucioni për të mundësuar mobilitetin e studentëve në nivel ndërkombëtar (pika 1.9; **Kapitulli III, Standardi III.4**).

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Organigrama e institucionit përcakton një strukturë të qartë organizative, e cila është e shpallur në faqen e internetit. [A1 fq. 12; <http://umt.edu.al/new/index.php/52-organizimi/150-struktura-organizative>; M2; M5] Statuti përshkruan përgjegjësitë e komisioneve kryesore, konkretisht të Bordit të Lartë Drejtues, Këshillit Administrativ dhe Senatit, [A3; M1b] si edhe detyrat e roleve të drejtuesve të lartë: Rektorit, Zëvendës Rektorit dhe Sekretarit të Përgjithshëm. [A3] Rregulloret e institucionit përcaktojnë detyrimet e drejtuesve të lartë, për shembull, Rregullorja e Fakultetit përcakton detyrat e dekanëve [A15] dhe Rregullorja e departamentit përcakton ato të Përgjegjësit të Departamentit. [A16] Stafit me kohë të pjesshme me ekspertizë profesionale të specializuar plotëson punën e stafit akademik me kohë të plotë. [A13 fq.5; M6] [Kapitulli III, Standardi IV.1; Kapitulli III, Standardi II.2]

2.2 Institucioni ka një proces të qartë, të dokumentuar dhe në përputhje me ligjin, për rekrutimin e stafit. [A32; C6] Çdo vend i lirë pune dhe kriteret e përzgjedhjes shpallen në faqen e internetit, në rrjetet sociale dhe në gazetatat kombëtare. [A1 fq. 12; A34; M6] Procesi i përzgjedhjes përfshin, fillimisht identifikimin e aplikimeve me shkrim, [A35; A36] të pasuar nga intervistat, të cilat vlerësohen nga një skemë e paracaktuar pikëzimi. [A24.1] Gjatë emërimeve akademike, përparësi i jepet atyre që kanë marrë kualifikime nga universitete evropiane. [A43 pjesa 4; M1a; M1b; M3] Fakulteti dhe departamenti janë përgjegjës për përzgjedhjen e stafit akademik dhe zyra përkatëse administrative për personelin mbështetës. [A32; C6; M1b; M6][Kapitulli III, Standardi IV.1]

2.3 Stafit i sapoemëruar merr pjesë në procesin e orientimit, që siguron marrjen e informacionit të nevojshëm. Ky proces përfshin takime me stafin drejtues përkatës dhe përgjegjësit e departamenteve, me të cilët ata kanë marrëdhënie në funksion të mbarëvajtjes së punës; stafit joshqiptar i caktohet një mentor akademik nga departamenti. [A1 fq.13; M6] Institucioni, gjithashtu organizon aktivitete sociale, për të mundësuar integrimin e stafit dhe studentëve në vendin e punës, për shembull: festimi i arritjeve institucionale, konkurse fotografie, leksione të hapura dhe aktivitete sportive. [A43][Kapitulli III, Standardi IV.2]

2.4 Institucioni përkrah projektet sociale në mbështetje të grupeve të disavantazuara, si për shembull “Ne dhurojmë për ju”, duke angazhuar Stafin dhe studentët, dhe “Dua të të bëj të lumtur”, një projekt i studentëve, me qëllim rehabilitimin e shtëpive të shkatërruara për familjet në nevojë. [A49; M3] Siç parashikohet edhe në ligj, ai i siguron stafit sigurimet shëndetësore. [A1 fq.15] [Kapitulli III, Standardi IV.4]

2.5 Institucioni ka një Politikë për Zhvillimin e Vazhdueshëm të Stafit, që përcakton përparësitë e trajnimit, për shembull zhvillimin e stafit të mësimdhënies dhe mbështetjen e stafit të angazhuar në kërkimin shkencor. [B15; C1; M5] Performanca e stafit vlerësohet çdo semestër nga përgjegjësit e departamentit, që bazohen në feedback-un e studentëve. [A44] Kjo mbështet Komisionin e Vlerësimit të Performancës, që miraton bursat, shpërblimet dhe ngritjen në detyrë [A45; A39; M5; M6] [Kapitulli III, Standardi IV.3]

2.6 Si një institucion privat, i vetëfinancuar, të ardhurat vijnë nga tarifat e shkollimit, donacionet dhe shoqëria themeluese. [A3 pjesa 41.5] Statuti dhe Rregullorja Financiare përshkruajnë proceset e menaxhimit financiar, të cilat konfirmohen në mbledhjet përkatëse. [A3, Kap. IV; A50; M1a; M2] Institucioni harton buxhetin vjetor në përputhje me udhëzimet statutores. Këshilli Administrativ, i mbështetur nga Zyra e Financës dhe çdo departament, harton një propozim për buxhet, që diskutohet në nivel fakulteti dhe Senati, përpara se t'i dërgohet për miratim Bordit të Lartë Drejtues [A1 fq.15; A3, Kap.IV & pjesa 19; A50 pjesa 17; M1a; M2; M6] Më pas, Zyra e Financës iu shpërndan buxhetet departamenteve, për të cilët kanë përgjegjësi përgjegjësit e departamenteve. [A1 fq.15; M6] Nëse gjatë vitit del ndonjë nevojë, Bordi i Lartë Drejtues mund të marrë kërkesa për përshtatje të buxhetit, për shembull financimi emergjent për të mbuluar shpenzimet e një eksperti të jashtëm të

nevojshëm për një program të ri. **[M1a; M2]** Gjatë vitit financiar, Bordi i Lartë Drejtues mbikëqyr të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit, me anë të raporteve tre-mujore, që në përputhje me legjislacion për kontabilitetin, përgatiten në bazë të parimeve të besueshmërisë, transparencës, qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë. **[A3 Kap.IV; M3]** Pasqyrat financiare të fundvitit të institucionit i nënshtrohen procedurave të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm. **[A3 Kap.IV; M1a; M2]** Stafi akademik dhe administrativ, që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, treguan se i kuptonin procedurat financiare dhe buxhetore. **[Kapitulli III, Standardi VI.1, Kapitulli III, Standardi VI.2, Kapitulli III, Standardi VI.3]**

2.7 Statuti ka protokolle me informacione të qarta për menaxhimin e tij. **[A3 pjesa 40; M6]** Qendrat e Sistemeve të Informacionit menaxhon infrastrukturën e TI-së dhe pajisjet. Institucioni ka një sistem sekretarie informacioni për funksionet administrative, duke përfshirë regjistrimin, kurrikulën dhe vlerësimin, që përpilon raporte statistikore për përdorimin e jashtëm dhe të brendshëm; ai ka edhe një portal për studentët dhe stafin. Portali i studentëve ofron akses konfidencial në rezultatet e provimeve dhe në detajet e frekuentimit. **[A1 p.16; A51; M2; M3; M6]** Sistemet aksesohen nëpërmjet llogarive individuale me anë të një fjalëkalimi. **[A52]** Institucioni publikon në faqen e internetit informacione për programet akademike, ditët e hapura dhe vendimet e Senatit Akademik. **[A1; fq.17; M2; M6][Kapitulli III, Standardi VII.1]**

2.8 Institucioni ofron një rrjet kompjuterik të sigurt, të lidhur në server, me akses 24/7 në internet, për akademikët dhe studentët, dhe në auditorë ka pajisje moderne audiovizive. **[A1 fq.18; C10 fq.19; Turi 1]** Ka gjashtë laboratorë TI dhe pesë programe kompjuterike në mbështetje të programeve të inxhinierisë kompjuterike të institucionit. Biblioteka ka një rrjet të përgjithshëm kompjuterësh. **[Turi1]** Në kohën e realizimit të vlerësimit të jashtëm, institucioni nuk ofronte programe të të nxënit në distancë. **[Kapitulli III, Standardi VII.2]**

2.9 Bordi i Lartë Drejtues menaxhon tre pasuritë e mirëmbajtura të institucionit. Ka të dhëna të qarta për kontratat e pronat e lëshuara me qira **[A1 fq.18; A4, fq.7; A58]** dhe për certifikatat vjetore higjieno-sanitare dhe certifikatat e mbrojtjes nga zjarri. **[A1 fq.20; A63; C12]** Plani strategjik për pronat planifikon ta zhvendosë institucionin në një vend në afërsi të Liqenit Artificial të Tiranës, në fundit të vitit 2017, ose në fillim të vitit 2018; kjo ndërtesë është në zhvillim e sipër. **[A1 fq.18, fq.20; A64]** Ambientet aktuale të institucionit përfshijnë auditorë, punishte, laboratorë, një bibliotekë, salla mbledhjesh, akomodim për stafin dhe një auditor për konferenca. Këto ambiente i përmbushin kërkesat ligjore, duke përfshirë akustikën dhe kërkesat për hapësirën. **[A1 fq.20; A13 fq.10; A14 fq.3]** Institucioni menaxhon me efikasitetet asetet e tij, për shembull, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka inventar për pajisjet dhe protokolle të posaçme për shëndetin dhe sigurinë; institucioni ka hapur edhe gjashtë laboratorë kompjuterësh për vitin akademik 2016-2017, për të përmbushur nevojat e programit. **[C10; M1a] [Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5]**

2.10 Biblioteka, e cila ndodhet në kat të fundit të ndërtesës kryesore, ka 464 libra në format të shtypur dhe **[A42]** 139 libra elektronikë, që mundësohen nëpërmjet abonimit të institucionit në "McGraw-Hill", duke i bërë tekstet aktuale lehtësisht të aksesueshme. **[A31; A31.1]** Duke marrë parasysh angazhimin në rritje të institucionit në veprimtarinë kërkimore, si edhe faktin që prej vitit 2014 numri i Studentëve është thajse dyfishuar, **[A13 fq.4]** duke zgjeruar në këtë mënyrë kërkesat kërkimore për tezën e diplomës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si një **dobësi** mungesën e shërbimeve të zgjeruara të bibliotekës në mbështetje të veprimtarisë kërkimore të studentëve dhe stafit. **Rekomandohet** që institucioni të rishikojë me përparësi, stokun e librave në bibliotekë, për të siguruar përmbushjen e nevojave të studentëve dhe stafit. Duke marrë parasysh vlerësimin e studentëve për bibliotekën online, **[M3]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** ofrimin në rritje të burimeve online të "McGraw Hill". **[Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi V.1]**

2.11 Ka shërbim të mirë për arkivimin, që mbështet mbajtjen e dokumentacionit kulturor dhe shkencor. **[A1 fq.18; A3 pjesa 40; A59; Turi1]** Çdo departament i ruan të dhënat në mënyrë elektronike, për shembull, dëshmi nga konferencat, botime të stafit dhe materiale për aktivitete periodike të institucionit. **[A1 fq.19; A19; A23; A43; A49]** Pyetësorët e shpeshtë të studentëve, që përfshijnë pyetje për ambientet, ofrojnë bazën për përmirësimin e vazhdueshëm, **[A73; B12]** për shembull, përmirësime të mensës. **[Turi 1]** Studentët i vlerësojnë ambientet e mësimdhënies si të mjaftueshme për nevojat e tyre, **[Anketimi i studentëve, Q12.i-v & Q13.i; M3]** megjithëse disa prej tyre evidentuan mungesën e rampave për personat me aftësi të kufizuara **[Anketimi i studentëve, Q15.i; M3]** dhe se ashensori në ndërtesën kryesore nuk shkon deri në katin e fundit, ku ndodhet edhe biblioteka, duke vështirësuar aksesin për ata me aftësi të kufizuara fizike. Pavarësisht planeve për t'u zhvendosur në vitin 2018, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si një **dobësi** mungesën e aksesit për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha burimet e të nxënies. Rekomandohet që institucioni të marrë masa në mënyrë urgjente, për të siguruar aksesin e personave me aftësi të kufizuara. **[Kapitulli III, Standardi VII.4; Kapitulli III, Standardi VII.6]**

2.12 Shumica e stafit akademik janë të kënaqur me akomodimin e tyre (që përfshin aksesin në kompjuterë dhe internet). **[Anketimi i stafit, Q7.xix]** Institucioni ka kapacitete të mjaftueshme për të organizuar aktivitete të jashtme rastësore dhe konferenca pa pagesë. **[A1 fq.5; M6] [Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi VII.6]**

2.13 Institucioni ofron shërbime për dokumentimin e veprimtarive akademike në format të shtypur dhe atë elektronik, duke përfshirë informacion për programet, analizë të të dhënave të studentëve dhe një bazë të dhënash për studentët, që mbulon regjistrimin, vlerësimin dhe diplomimin. **[A9; A51; A59; M6][Kapitulli III, Standardi IV.1]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e shërbimeve të gjera të bibliotekës, në mbështetje të veprimtarisë kërkimore të studentëve dhe stafit (pika 2.10; **Kapitulli III, Standardi V.1**)
- mungesa e ofrimit të aksesit gjithëpërfshirës në burimet e të nxënësve me aftësi të kufizuara (pika 2.11; **Kapitulli III, Standardi VII.4**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- të rishikojë stokun e librave të bibliotekës, për të siguruar se ajo i përmbush nevojat e studentëve dhe stafit (pika 2.10; **Kapitulli III, Standardi V.1**)
- të marrë hapa për të siguruar aksesin në ambiente të personave me aftësi të kufizuara (pika 2.11; **Kapitulli III, Standardi VII.4**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- shërbimet në rritje të burimeve të bibliotekës online “McGraw Hill” (pika 2.10; **Kapitulli III, Standardi V.1**).

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Institucioni ofron katër programe të nivelit Bachelor dhe shtatë programe të nivelit Master **[A13]** në fushat e studimit të ekonomisë dhe inxhinierisë, në përputhje me Statutin. **[A3]** Këto informacione publikohen në faqen e internetit të institucionit, [<http://en.umt.edu.al/>] duke ofruar detaje në lidhje me titullin e programit, një përshkrim të shkurtër të tij, lëndët që do të zhvillohen çdo semestër dhe kreditet ECTS përkatëse. Ka edhe specifikime të detajuara për programet **[B5]**, por nuk janë të aksesueshme nga publiku në faqen e internetit. Senati Akademik miraton numrin dhe kriteret për pranimin e studentëve, në vijim të propozimeve nga departamentet dhe në bazë të kuotave të lira. **[A65]** Zyra e Këshillimit të Karrierës përpilon broshura informuese **[A89]** dhe organizon aktivitete këshillimi për maturanët, **[M6]** ditë të hapura dhe vizita në institucionet nga ku vijnë studentët më të shumtë. **[A21; B23]** Institucioni ofron kurse falas afatshkurtra për maturanët, në lëndë si matematika, fizika, ekonomia dhe arkitektura, nga marsi deri në maj të çdo viti, për t'i përgatitur ata për studimet universitare. **[A62]** **[Kapitulli I, Standardi I.1]**

3.2 Orientimi i Studentëve të rinj organizohet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës; studentët që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm u shprehën të kënaqur me orientimin dhe informacionin e dhënë, **[B25]** për shembull me Manualin e studentëve, **[B4]** oraret, objektivat e modulit dhe vlerësimin. **[M3]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me pedagogët dhe personelin mbështetës, bëri një vizitë në ambientet e Institucionit dhe arriti të aksesonte portalin e studentëve për të marrë më shumë informacion. **[M6]** Institucioni jep bursa bazuar në kushte specifike shoqërore, në performancën në shkollën e mesme ose për transferimin nga një institucion tjetër. **[A72; A90; A91]** Studentët mbështesin fuqishëm mundësinë e përfitimit të bursave. **[M3]** **[Kapitulli I, Standardi I.1; Kapitulli I, Standardi I.8]**

3.3 Programet organizohen në module dhe bazohen në kredite ECTS, ku programet e nivelit Bachelor për ciklin e parë kanë 180 kredite, ndërsa programet e nivelit Master i ciklit të dytë kanë 120 kredite. **[B5]** Programet e nivelit Bachelor zhvillohen gjatë tre viteve, ndërsa programet e nivelit Master gjatë dy viteve. Programi i Masterit të integruar në Arkitekturë, që fillon në vitin 2017, do të zhvillohet gjatë pesë viteve dhe do të ketë 300 kredite. **[A1]** Specifikimet e programeve **[B5]** ofrojnë informacione të detajuara për lëndët, duke përfshirë kreditet ECTS, strukturën e vitit akademik, objektivat, vlerësimin, përmbajtjen e lëndës dhe referencat. Si rrjedhojë, këto specifikime japin udhëzime të qarta për titullarin e lëndës. **[Kapitulli I, Standardi I.1]**

3.4 Institucioni nuk zhvillon programe studimi me kohë të pjeshme, ose të të nxënit në distancë **[A13]**, por ofron kurse të të nxënit gjatë gjithë jetës. **[C9]** Programi i trajnimit në "Vlerësim dhe Investim në Pasuritë e Paluajtshme" **[M4]**, që ofron edhe licencim nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, dhe kursi i trajnimit për edukim në vazhdim në "Menaxhim i Projekteve në nivel Evropian", janë dy prej programeve më të rëndësishme. **[A25]** Institucioni ka një metodë për mbledhjen e feedback-ut nga studentët, për sa i përket përvojës së tyre në lëndët e zhvilluara. **[A73]** Pyetësori përfshin programet e studimit, mësimdhënien, vlerësimin dhe burimet, dhe përdoret si pjesë e vlerësimit në fund të kursit, për të propozuar ndryshime për vitin e ardhshëm. Studentët pohuan se iu dëgjohet zëri dhe se bëhen ndryshime, nëse është e nevojshme. **[M3]** **[Kapitulli I, Standardi I.2]**

3.5 Strategjia e Zhvillimit **[A4]** përcakton qartazi se misioni i institucionit është përgatitja e profesionistëve dhe specialistëve në përmbushje të nevojave të ndryshueshme të shoqërisë në lidhje me teknologjinë dhe fushat e ekonomisë, nëpërmjet programeve të mësimdhënies. Si rrjedhim, programet e ofruara të niveleve Bachelor dhe Master janë qartësisht në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit. Me përfundimin e suksesshëm të programeve të studimit, studentët marrin një diplomë dhe një suplement të diplomës, që paraqet detaje për lëndët, nivelin dhe kreditet e marra. **[B5]** **[Kapitulli I, Standardi I.3]**

3.6 Programet e studimit synojnë kryesisht nevojat e tregut të punës në Shqipëri dhe në vendet fqinj, **[M1a]** por studentëve iu kërkohet të kenë njohuri bazë në gjuhën angleze, të vërtetuar nëpërmjet testeve të njohura në nivel ndërkombëtar, për t'u pranuar në programet e ciklit të dytë. Të gjithë studentët e regjistruar në programet e studimit frekuentojnë një modul për gjuhën angleze në semestrin e parë në vit të parë, **[B5; <http://en.umt.edu.al/>]** që i ndihmon ata me terma teknikë në anglisht dhe zhvillon aftësinë e tyre për të kuptuar referencat. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohoi** zhvillimin e modulit "Gjuhë angleze", që nxit mobilitetin e studentëve dhe i mundëson atyre të përfitojnë nga botimet ndërkombëtare. Një pjesë e ndërveprimit kulturor të përfituar është rezultat i punësimit të stafit akademik të huaj me kohë të plotë. **[A1; A13]** Megjithatë, ka një kërkesë të madhe për të diplomuarit në ekonomi dhe inxhinieri, siç dëshmohet nga normat e larta të punësueshmërisë të të diplomuarve. **[B7]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konsideron si karakteristikë të **praktikës së mirë** specifikimet e detajuara të moduleve, që iu mundësojnë studentëve të përvetësojnë aftësi në inxhinieri dhe ndërmarrje të nevojshme në Shqipëri, në përputhje me strategjinë e institucionit. **[Kapitulli I, Standardi I.4]**

3.7 Senati Akademik vendos për ngarkesën vjetore të punës për stafin akademik, e cila arrin një maksimum prej 300 orësh në vit për çdo pedagog, **[A69]** përjashtuar veprimtarinë kërkimore dhe administrative. Departamentet planifikojnë orët e mësimdhënies dhe kërkimit, para fillimit të vitit akademik, **[A67]** sipas kërkesave të kalendarit dhe orarit, **[A77]** si edhe në përputhje me kontratat individuale të stafit. **[A68]** Veprimtaritë e mësimdhënies përfshijnë leksione, seminare, vlerësime dhe praktikë profesionale, që miratohen nga përgjegjësi i departamentit. **[M5]** Institucioni ka 51 anëtarë me kohë të plotë dhe 47 anëtarë me kohë të pjesshme, **[A13]** të cilët kanë më pak ngarkesë mësimore. Gjithashtu thirren specialistë të fushës, kur është e nevojshme. **[M5]** Si rrjedhojë, programet e studimit ofrohen në përputhje me kapacitetet institucionale. **[Kapitulli I, Standardi I.5]**

3.8 Programet e studimit të ofruara janë lehtësisht të kuptueshme, qartësisht të përcaktuara **[B5]** dhe të aksesueshme nga studentët. **[M3]** Kriteret e pranimit përcaktohen qartësisht në Statut **[A3]** dhe në Rregulloren e Brendshme. **[A6]** Studentët që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm pohuan se i kuptojnë plotësisht synimet dhe objektivat e programit në të cilin po studionin, si edhe kriteret e pranimit. **[M3]** **[Kapitulli I, Standardi I.6]**

3.9 Programet e studimit të nivelit Bachelor në ciklin e parë i pajisin studentët me njohuri bazë dhe me parime të përgjithshme shkencore, **[B5]** që mundësojnë ecurinë në programet e studimit të nivelit Master të ciklit të dytë, ose i orientojnë studentët drejt punësimit, që mbështetet nga praktika profesionale gjatë programit. **[A27]** Programet e ciklit të dytë kanë një bazë në rritje të kërkimit dhe mbështeten plotësisht nga punëdhënësit dhe palët e tjera të interesit, për shembull, nëpërmjet shfrytëzimit të projekteve faktike. **[M4]** Alumni që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm shprehën mirënjohje për parimet teorike të mësuara në universitet dhe pohuan se këto njohuri i përgatiten për punësim. **[M4]** **[Kapitulli I, Standardi I.7]**

3.10 Programet e studimit të nivelit Master të ciklit të dytë mbështeten shumë në veprimtarinë kërkimore dhe shumë prej anëtarëve të stafit akademik përfshihen në veprimtaritë kërkimore. **[M5]** Për më tepër, teza e diplomës së Masterit përbën një mundësi për pjesëmarrje të studentëve në veprimtarinë kërkimore të zhvilluar nga stafi akademik dhe në punën me sektorin e industrisë. **[M4;M5]** **[Kapitulli I, Standardi I.8; Kapitulli I, Standardi I.9]**

3.11 Programet hartohen në përputhje me marrëveshjet e Bolonjës, **[B5]** në cikle të njëpasnjëshme; studentët pajisen me një diplomë dhe një suplement të diplomës **[A70; A71]** si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze. **[A75]** Kjo iu mundëson studentëve të transferon në këto programe dhe në programe të tjera, ose në vende të tjera evropiane. Megjithatë, nuk ka dëshmi që të vërtetojnë realizimin e kësaj praktike, të paktën në një shkallë të konsiderueshme (shihni paragrafin 1.9). **[Kapitulli I, Standardi I.10]**

3.12 Zhvillimi i kurrikulës për programet ekzistuese realizohet në baza vjetore, nëpërmjet propozimeve nga stafi akademik, që fillimisht i kalojnë përgjegjësit të departamentit dhe dekanit dhe më pas Senatit, për miratim. **[M5]** Këto zhvillime ndërmerren bazuar në përgjigjet e pyetësorit të studentëve, **[M2; M3; A73]** ose në pikëpamjet e stafit akademik. **[M5]** Zhvillimet e programeve të reja ndërmerren bazuar në studimin e tregut, për shembull, për programin e nivelit Master në arkitekturë. **[A19; B6; C13]** Zhvillimi i vazhdueshëm i kurrikulës, në përgjigje të kërkesave të tregut të punës, i mundëson programeve të studimit të integrojnë zbatimin praktik të njohurive të kërkuara për punësim në fushat përkatëse. **[Kapitulli I, Standardi I.11]**

3.13 Institucion i vuri në dispozicion Grupit të Vlerësimit të Jashtëm një raport me të dhëna statistikore për punësimin e të diplomuarve, sipas programit dhe për secilin nga të diplomuarit. **[B7]** Rezultatet dëshmuar se për programet e nivelit Bachelor, 80-100 për qind e të diplomuarve ose janë të punësuar, ose ndjekin studime të mëtejshme; ndërsa për programet e nivelit Master, 78-100 për qind janë të punësuar. Studentët, punëdhënësit dhe alumni që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm i pohuan këto norma të larta punësimi dhe aftësitë përkatëse të punësimin të përvetësuar. **[M3; M4]** **[Kapitulli I, Standardi I.12]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- specifikimet e detajuara të moduleve, që iu mundësojnë studentëve në Shqipëri të përvetësojnë aftësi inxhinierike dhe sipërmarrjeje, në përputhje me strategjinë e institucionit (pika 3.6; **Kapitulli I, Standard il.4**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- zhvillimi i modulit “Gjuhë angleze”, që nxit mobilitetin e studentëve dhe iu mundëson atyre që të përfitojnë nga botimet ndërkombëtare. (pika 3.6; **Kapitulli I Standardi I.4**)

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Institucioni sigurohet që programet e studimit të jenë të përditësuara, nëpërmjet procesit të rishikimit vjetor. Departamentet, bazuar në feedback-un e studentëve, propozojnë ndryshimet e nevojshme, që i kalohen për miratim Këshillit të Fakultetit dhe Senatit [A3; A16; M5] dhe pasqyrohen në dokumentacionin e programit të rishikuar. Organizmi i programit të studimit merr parasysh ekuilibrin e ngarkesës mësimore të stafit akademik, për t'u siguruar se akademikët kanë hapësirë për të ndërmarrë veprimtari administrative, kërkimore dhe mësimdhënieje, duke përfshirë mbikëqyrjen e praktikës profesionale, stazhit dhe përgatitjes së tezës së diplomës. [A1 fq.32; M1a; M2; M6] Departamentet, për të përmbushur kërkesat mësimore për specialist, i bëjnë kërkesë dekanatit për të miratuar pedagogë shtesë me kohë të plotë. [A67; A69][Kapitulli I, Standardi II.1]

4.2 Rregullat e institucionit për provimin dhe diplomimin, janë të mirëpërcaktuara. [A6; A78; A75] Studentëve iu jepen specifikime në lidhje me programet, që përshkruajnë rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e vlerësimit. [B4] Kalendar i provimeve njoftohet paraprakisht dhe, pas miratimit, publikohet në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale. [A78; M3; M6] Tezave të diplomimit iu vihet një barkod, për të siguruar anonimitetin gjatë korrigjimit. [A78] Studentët mund t'i aksesojnë rezultatet e provimeve në mënyrë individuale, duke hyrë në portalin e studentëve, [www.bit-albania.com/umt.php] ose mund të pyesin në sekretari. [M3; A78] Studentët kanë të drejtë ta ankimojnë notën e marrë, duke dorëzuar një ankim brenda tre ditëve nga shpallja e rezultateve. [A6 pjesa 41; A63 pjesa 16; B7; B8; Anketimi i studentëve, Q23; M6; M3] Në përmbushje të kërkesave të provimeve, studentët pajisen me një diplomë dhe një suplement diplome, [B4] që miratohet dhe regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Diplomave dhe Certifikatave. [A1; fq.30; A7][Kapitulli I, Standardi II.2]

4.3 Programet e studimit iu nënshtrohen rishikimeve periodike, që nxisin përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike. [A3 pjesa 24; A9] Studentët vlerësojnë performancën e pedagogëve në veçanti, në fund të çdo moduli, [A73; B10] plotësojnë një pyetësor të përvitshëm, që mbulon programin dhe të gjitha shërbimet mbështetëse, [A73; B10] dhe gjatë vitit, ata japin mendimin e tyre, nëpërmjet grupeve të orientimit dhe Këshillit Studentor. [A87; A88] Departamentet, të mbështetur nga analiza e përgatitur nga Qendra e Vlerësimit të Brendshëm, rishikojnë rezultatet e pyetësorëve, duke përfshirë pikëpamjet për punëdhënësin, [B6a; M1b; M2; M4] dhe bëjnë propozime për përmirësime të programit që diskutohen dhe miratohen nga Këshillat e Fakultetit dhe nga Senati Akademik. [A9; M2; M5; M6] Përmirësimet që rrjedhin nga ky proces përfshijnë ofrimin e gjashtë laboratorë të rinj për inxhinierinë kompjuterike, për vitin akademik 2016-2017. [A1 fq.31 M1a; Turi 1] [Kapitulli I, Standardi II.3]

4.4 Këshilli i Vlerësimit të Cilësisë nxit përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe është përgjegjës për trajnimin e stafit akademik. [A1 fq.31; A9 fq.4] Përpos vlerësimeve të pedagogëve prej studentëve, përgjegjësit e departamenteve shqyrtojnë çdo semestër performancën e të gjithë akademikëve. [A44 fq.5; B14] Politika e institucionit për Zhvillimin e Vazhdueshëm të Stafit [A3 pjesa 3e; A4 fq.5] parashikon veprimtarinë kërkimore të stafit akademik dhe trajnimin pedagogjik, [A1 fq.31; C1; M1b; M2; M5; M6] për shembull për "Neural Networks and Deep Learning" [Libër për programet kompjuterike]. [C1] [Kapitulli I, Standardi II.4]+

4.5 Struktura e fakultetit përbëhet nga gjashtë departamente, që përbëjnë njësitë themelore të mësimdhënies dhe kërkimit të institucionit, konkretisht: Inxhinieri Ndërtimi; Inxhinieri Elektronike dhe Teknologji Informacioni (Fakulteti i Inxhinierisë); Administrim Biznesi; Informatikë Ekonomike (Fakulteti i Ekonomisë); dhe dy qendra kërkimore shkencore të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Fakultetit të Ekonomisë. [A3 fq.6] Çdo njësi në veçanti nxit

dhe menaxhon veprimtarinë kërkimore përkatëse për çdo disiplinë, duke respektuar lirinë akademike, duke siguruar lidhjen ndërmjet kërkimit dhe lëndëve të zhvilluara, duke vendosur prioritetet e kërkimit dhe duke mbikëqyrur buxhetin e departamentit. **[A3 pjesa 36; A6 pjesa 8; A15 pjesa 10]** *[Kapitulli II, Standardi I.1]*

4.6 Aktualisht, financimi i veprimtarisë kërkimore sigurohet kryesisht nga institucioni, pas miratimit nga Senati dhe Bordi i Lartë Drejtues, **[C3]** duke pasur edhe disa projekte të financuara nga jashtë, si “Ciceroni Virtual”, i financuar nga Ministria e Kulturës. **[A47; B19]** Institucioni i nxit departamentet të krijojnë partneritete me kompani që janë në pronësi të shoqërisë themeluese, që mbështet transferimin e teknologjisë: duke përfshirë “MetroResearch” (qendër kërkimi që mundëson ndërmjetësimin e partneriteteve) dhe filialet e tij, “Metropolitan Incubator” (inkubatori i parë në Shqipëri brenda kampusit të universitetit) dhe Qendra “Metropolitan Geospatial” (specialistë të infrastrukturës). **[A1 fq.34;** <http://en.umt.edu.al/index.php/research/metroresearch>; **M1b; M2; M6]** Për shembull, “Metropolitan Incubator”, i krijuar në vitin 2015, i mundëson stafit dhe studentëve që të bëjnë rezultatet kërkimore në TI të tregtueshme, nëpërmjet shoqërive start-up, **[B18; A55; A56; M1a; M2; M5]** siç është Python për Fëmijë. [<http://mincubator.al/startup-companies/>; **A57; B19; M1a; M6; Turi 2]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si një praktikë të mirë mbështetjen për komercializimin e teknologjisë së inovacionit, të siguruar nga inkubatori i institucionit për biznesin. *[Kapitulli II, Standardi I.2]*

4.7 Ndërkombëtarizimi përbën një objektivi kyç të Strategjisë së Zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë të institucionit. **[A4 fq.6-9; M2; M4; M5]** Kjo arrihet nëpërmjet pjesëmarrjes në konferencat ndërkombëtare **[A28; A23]** dhe nëpërmjet organizimit të workshop-eve dhe simpoziumeve ndërkombëtare. **[A27]** Institucioni ka krijuar një sërë partneritetesh me institucione të huaja të arsimit të lartë, **[A26]** që ofrojnë bazën për zhvillimin e ofertave për financimin e kërkimit nga BE-ja. **[A47; M3; M4; M5]** Disa akademikë kanë botuar artikuj në revista ndërkombëtare shkencore **[A82]** dhe kanë shërbyer si kritikë të revistave. **[A80]** Thuajse 30 për qind e stafit kanë përfituar tashmë nga studimet jashtë shtetit. **[Anketimi i stafit akademik Q3; B25; M3]** Megjithëse kjo praktikë nuk është në shkallë të gjerë, përbën një hap të rëndësishëm për themelimin e një kulture të kërkimit shkencor, duke marrë parasysh edhe faktin se institucioni u krijua në vitin 2010. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** politikën e institucionit për të investuar te stafi akademik dhe pedagogë që kanë punuar jashtë shtetit për arsye kërkimore ose trajnimi, duke mbështetur në këtë mënyrë ndërkombëtarizimin institucional. *[Kapitulli II, Standardi I.3]*

4.8 Në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit, institucioni mbështet kërkimin shkencor në fushat e fakulteteve të tij, përkatësisht Inxhinieri, Gjeoteknikë, **[C7; M4]** Biznes dhe Ekonomi, duke përfshirë analizën e tregut të punës, **[A4 fq.4]** dhe nxit debatin shkencor në këto fusha, për shembull, nëpërmjet organizimit të konferencave. **[A28; A23; M3; M5]** Në politikat dhe praktikatat e rekrutimit, institucioni i jep përparësi rekrutimit të stafit me kualifikime evropiane, veçanërisht atyre që kanë kryer studime doktrate dhe kanë botime të kërkimit shkencor **[A32 fq.4; A33; A83; M1a; M1b; M3; M5]** dhe fton gjithashtu lektorë për të dhënë mësim dhe leksione. **[A30]** Akademikëve iu ofrohet financim i brendshëm për pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare; akademikët marrin gjithashtu mbështetje si nga MetroResearch **[A47; C8; C15; M5; M6]** që lidh partneritete, ashtu edhe Metropolitan Incubator, që nxit transferimin e njohurive. **[A55; A56; M5; M6]** *[Kapitulli III, Standardi I.4; Kapitulli III, Standardi I.5]*

4.9 Strategjia e Zhvillimit përcakton objektivat afatmesme dhe afatgjata të institucionit, që përshijnë përqendrimin te zgjerimi i veprimtarisë kërkimore në nivel ndërkombëtar. **[A4; M1a, M2]** Për të mbështetur politikatat shkencore rajonale dhe kombëtare, **[A25; A26; M4]** Institucioni ka krijuar partneritete të efektshme me komunitetin vendor të biznesit, për shembull me TT-Soil dhe Earthquake Consulting. Institucioni, së bashku me këtë kompani dhe me mbështetjen e MetroResearch, organizoi simpoziumin e parë në Shqipëri, në vitin 2013, për trajnimin mbi pajisjen CPT. [<http://www.insitushi.com/2015/11/26/cpt-training->

course-in-albania/; **M4**] Për më tepër, ma anë të partneritete bashkëpunuese, institucioni mundi të kishte pronësinë e pjeshme të pajisjes CPT, që është një burim kyç në testimin gjeoteknik në rajonin e Shqipërisë, në mbështetje të kërkimit shkencor dhe praktikës profesionale për studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit. **[C7; M4]** Konsiderohet si **praktikë e mirë**, bashkëpunimi i mirëstrukturuar i institucionit për zhvillimin dhe përdorimin e pajisjes CPT, që ka mundësuar krijimin e lidhjeve të forta me biznesin, zhvillimin e kërkimit në bazë të praktikës si për stafin, ashtu edhe për studentët, dhe për përparimin e axhendës së veprimtarisë kërkimore si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar. Institucioni nuk ofron programe doktrate, megjithëse tezat e diplomës të Masterit mbështesin vazhdimisht fokusin e institucionit te veprimtaria kërkimore. **[A84; A85; C14; M5]** Si një mënyrë për të forcuar më tej cilësinë dhe kapacitetin e kërkimit, institucioni fton studiues të njohur si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, për të kontribuar në veprimtarinë shkencore. **[A17, A23; M1a; M5] [Kapitulli II, Standardi I.6]**

4.10 Institucioni mbështet shpërndarjen e rezultateve të kërkimit të stafit **[A1 fq.35; C3]** nëpërmjet vizitave jashtë shtetit **[A28; A38; M2; M5; M6]** dhe organizimit të konferencave akademike, workshop-eve dhe seminareve në Tiranë: për shembull në vlerësimin e pasurive të paluajtshme, në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në përdorimin e pajisjes CPT dhe tema kërkimore ndërkombëtare, që kontribuojnë në shkallë të gjerë për axhendën kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. **[A20]** Stafi pohoi se institucioni i financon vizitat, për pjesëmarrjen në konferenca, **[A1 fq.35; A28; M5]** studimet e doktoratës **[M6]** dhe përgatitjen e botimeve për revista, **[B19 fq.4]** si edhe mbështetjen financiare për anëtarët e stafit, për ta përshtatur tezën e diplomës si një artikull reviste. **[M5] [Kapitulli II, Standardi I.7]**

4.11 Siç dëshmohet në listën e botimeve dhe në raportin e kërkimit shkencor, **[A80; A81]** vazhdon ecuria për sa i përket kërkimit shkencor në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit: **[A4 fq.4]** për shembull, përdorimi në rritje i pajisjes CPT, vlerësimi i qëndrueshmërisë dhe i pasurive të paluajtshme, që prej vitit 2013; **[A80; A81; A82; M6]** dhe, mbështetja e MetroResearch në gjetjen e partneriteteve dhe financimit, që prej vitit 2015. **[M5; M6]** Shqyrtimi i veprimtarisë kërkimore kryet në nivel individual dhe **[A80]** në nivel projekti nga departamenti. **[B19]** Institucioni është kolegji universitar dhe ende nuk ka një strategji kërkimore ndërinstitutionale, të shoqëruar nga proceset e monitorimit dhe rishikimit. Megjithatë, metodat ekzistuese të shqyrtimit i mbështesin departamentet për të përcaktuar si objektivat kërkimore individuale, ashtu edhe ato të departamentit, duke identifikuar nevojat për financim dhe mbështetur punën e MetroResearch në gjetjen e fondeve për veprimtarinë kërkimore. **[M3; M6]** Përpos kësaj, institucioni e nxit stafin akademik të mbrojë pasurinë intelektuale, për shembull me anë të patentave. **[A67 ; A68 seksioni 14; B17 ; M5; M6] [Kapitulli II, Standardi I.8]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- mbështetja për bërjen teknologjisë së inovacionit të tregtueshme, e siguruar nëpërmjet inkubatorit të biznesit të institucionit, që mundëson transferimin e njohurive (pika 4.6; **Kapitulli II, Standardi I.2**)
- bashkëpunimi i mirëstrukturuar i institucionit për zhvillimin dhe përdorimin e pajisjes CPT, që ka mundësuar krijimin e lidhjeve të forta me bizneset e vendit, zhvillimin e kërkimit bazuar në praktikë, si për stafin, ashtu edhe për studentët, dhe përparimin e axhendës së veprimtarisë kërkimore të institucionit, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar (pika 4.9; **Kapitulli II, Standardi I.6**)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- politika e institucionit për të investuar te stafi akademik që ka punuar jashtë shtetit për arsye kërkimore ose trajnimi, duke mbështetur në këtë mënyrë ndërkombëtarizimin institucional (pika 4.7; **Kapitulli II, Standardi I.3**).

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Pranimi i studentëve bazohet në kriteret dhe kuotat e miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen e internetit të institucionit [<http://umt.edu.al/new>] dhe në portalin online "UAlbania", [<http://ualbania.arsimi.gov.al/Home/IndexHome>] si edhe nëpërmjet broshurave informuese dhe fushatave mediatike. **[A1 fq.36; A65 fq.36; B27; M3, M6]** Institucioni organizon një sërë veprimtarish për pranimin, duke përfshirë Ditët e Këshillimit të Karrierës, vizita dhe informacione në shkollat e mesme, që përshijnë udhëzime për aplikimin individual. **[A15.1; B22]** Me anë të kësaj pune, dhe nëpërmjet ofrimit të kurseve falas për maurantët, institucioni ka krijuar një rrjet të drejtorëve të shkollave. **[A1 fq.36; M6]** Studentët e rinj ndjekin workshop-e orientimi, ku njihen me institucionin, programet e tij, portalin online dhe oraret. **[A20; B24; B27]** Studentët pohuan se ky proces është i efektshëm. **[M3]** Në kohën e vizitës së vlerësimit të jashtëm, institucioni kishte 98 akademikë, 51 prej të cilëve ishin me kohë të plotë dhe 47 me kohë të pjesshme, dhe 724 studentë gjithsej (në ciklet e para dhe të dytë të studimit). Raporti student-staf është i qëndrueshëm dhe rregullohet nga legjislacioni. **[A13; M1a] [Kapitulli I, Standardi III.1]**

5.2 Institucioni i informon vazhdimisht studentët dhe stafin akademik në lidhje me çështje institucionale, duke përdorur një larmi të mënyra të komunikimit, duke përfshirë faqen e internetit, kalendarin e institucionit, portalin e studentëve, rrjetet sociale (Facebook dhe Instagram) dhe emailin. **[A1 fq.37; M2; M3; M6]** Në komunikimin e brendshëm, institucioni përdor monitorë, stenda afishimi dhe afishet, si edhe mënyrat e komunikimit verbal në klasa. **[A88; M1b; M6]** Stafi akademik e kuptonte mirë rrjedhën e informacioni ndërmjet niveleve të departamentit dhe Senatit. **[M5]** Studentët nxorën në pah rëndësinë e Këshillit Studentor, përfaqësuesit e studentëve në komisionet institucionale dhe Avokatin e Studentëve, si metoda për informimin e studentëve rreth çështjeve të institucionit ose procedurave të ankimimit. **[A69; M3; M6]** Institucioni ruan në sekretarinë mësimore një dosje personale në format fizik, për secilin nga studentët, që përmban adresën postare dhe adresën e emailit të studentit dhe numrat e kontaktit. Këto të dhëna ruhen edhe në bazën e të dhënave të departamentit. **[A1 fq.37; M2; M6] [Kapitulli I, Standardi III.2]**

5.3 Orientimi dhe këshillimi i studentëve në nivel institucional kryet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, Avokati i Studentëve dhe sistemi i tutoriatit institucional. **[A20; A87; M3; M6]** Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon workshop-e dhe seminare orientuese, duke përfshirë edhe trajnime për përgatitjen e CV-ve dhe letër motivimit për të aplikuar për punë. **[A1 fq.38; A20; M2; M6]** Avokati i Studentëve merret me çështjet e studentëve nga aspekti ligjor, duke përfshirë ankesat, dhe sigurohet se çështje të tilla i kalojnë për shqyrtim departamentit përkatës. [<http://umt.edu.al/new/index.php/studentet/2016-03-15-07-49-48/avokati-i-studentit>]; **B7; M5; M6]** Studentët mund të ngrenë çështje gjatë orientimeve/tutorimeve javore dhe të marrin udhëzime nga një pedagog-tutor akademik. **[M3]** Për më tepër, studentët kanë akses në informacionin për programet, siç janë fletëpalosjet dhe broshurat, për shembull Manuali i Studentëve, ose informacionin në lidhje me këshillimin për karrierën. **[A89; M6]** Institucioni ka një proces të qartë të mbështetjes së studentëve që transferohen nga dhe drejt institucioneve të tjera, ose transferohen nga një departament në një tjetër brenda institucionit. **[A6 pjesa 44]** Sekretaria mësimore mbledh kërkesat, të cilat shqyrtohen nga një panel i fakultetit, ndërsa dekani merr vendimin përfundimtar. **[A6 pjesa 44; A72; M2]** Në mbledhje të ndryshme u diskutua cilësia e mbështetjes së studentëve; studentët pohuan se ishin shumë të kënaqur me mënyrat e ndryshme të ofrimit të mbështetjes. **[M2; M3; M5; M6; Anketimi i studentëve, Q16] [Kapitulli I, Standardi III.3]**

5.4 Institucioni ka një politikë të mbështetjes së studentëve që vijnë nga grupet shoqërore të disavantazuara. **[A1 fq.38; M3]** Jepen bursa për kategori të veçanta shoqërore, siç janë: komuniteti rom dhe ballkano-egjiptian; fëmijët e ushtarakëve dhe policëve të vrarë, ose të plagosur në detyrë; studentët me aftësi të kufizuara, ata që vijnë nga familje me të ardhura të ulëta, ose atyre të diasporës. **[A90; B20; M3; M6]** Programi i

Bursave për 2016-17 përcakton me detaje kategoritë dhe kërkesat që duhen plotësuar për aplikimet. **[A90]** Për më tepër, institucioni i mbështet studentët, nëpërmjet dhënies së bursave për rezultate të shkëlqyera, ose për arsye të të ardhurave të ulëta. **[A91; M3]** Megjithatë, siç përmendet në pikën 2.11, mungesa e aksesit për personat me aftësi të kufizuara konsiderohet si dobësi. **[Kapitulli I, Standardi III.4]**

5.5 Biblioteka e institucionit synon të ofrojë literaturën bazë, të nevojshme për mbështetjen e programeve **[A1 fq.38; M6]** ofron libra në format të shtypur dhe akses të shtuar në librat online të bibliotekës “McGraw Hill”. **[A40-A42; M6]** Në fillim të çdo viti akademik, studentëve dhe stafit iu jepet një fjalëkalim për të aksesuar bibliotekën online. **[A41; M6]** Biblioteka fizike vazhdon të zgjerojë fondin e saj çdo vit, nëpërmjet donacioneve dhe blerjeve të reja, që rrjedhin nga kërkesat e pedagogëve për blerjen e librave dhe periodikëve shkencorë. **[A1 fq.39; M3; Anketimi i studentëve, Q13; biblioteka]** Megjithëse studentët ishin të mendimit se vetë biblioteka dhe librat online aktualisht i përbushin nevojat e tyre, siç përmendet në pikën 2.10, kapaciteti i vogël e bibliotekës në proporcion me rritjen e numrit të studentëve dhe angazhimet e institucionit për veprimtarinë kërkimore u konsideruan nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm si një dobësi. **[79; M3; Anketimi i studentëve]** **[Kapitulli III, Standardi III.5]**

5.6 Institucioni i mbështetet i studentët e ciklit të parë, nëpërmjet një larmi aktivitete, të ofruara me anë të funksioneve akademike dhe administrative, në veçanti Zyra e Këshillimit të Karrierës. **[A34]** Në fillim të çdo viti akademik, Rektori dhe përgjegjësit e departamenteve i mirëpresin studentët; zyrtat administrative i vënë në dijeni studentët për funksionet e tyre; dhe studentët caktohen në grupe tutorimi sipas programit të tyre të studimit, ku mund të ngrenë çështje gjatë vitit akademik. **[A1 fq.39; A87; A88; M1b; M2; M5]** Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës, iu ofron mbështetje studentëve që nga faza e aplikimit deri te praktika profesionale dhe përgatitja për punësim, si edhe integrimin në grupin e alumnit. **[http://umt.edu.al/new/index.php/studentet/2016-03-15-07-49-48/alumni; M3; M4; M6]** **[Kapitulli I, Standardi III.6]**

5.7 Studentët nxiten që të marrin pjesë në jetën universitare, në përputhje me Statutin; ata përfaqësohen në Senatin Akademik, **[A3 pjesa 18.4]** Këshillat e Fakultetit, Këshillin e Sigurimit të Cilësisë dhe Këshillin e Etikës, ku mund të shprehin mendimet e tyre. **[A1 fq.39; A3 pjesa 18; A9 pjesa 13; M3]** Institucioni ka një Këshill të zgjedhur Studentor, që është ngarkuar me trajtimin e çështjeve të studentëve, të financuar nga institucioni dhe mbikëqyret nga Zyra e Këshillimit të Karrierës. **[A86; M3; M6]** Studentët pohuan se Këshilli Studentor ka mbështetur zhvillimin e shoqatave të studentëve (për shembull Shoqata e Arkeologjisë); zhvillimin e projekteve ekstra kurrikulare të inovacionit social (për shembull, për fëmijët që nuk flasin); dhe zhvillimin e veprimtarive sportive (për shembull, futbollit dhe volejbollit). **[M3]** Për më tepër, studentët pohuan se zëri i tyre dëgjohej, me anë të pyetësorëve të realizuar rregullisht nga grupet javore të tutorimit, të Avokatit të Studentëve dhe një kutie ku mund të hedhin letra për sugjerime, dhe pohuan se institucioni iu është përgjigjur këtyre kërkesave, për shembull, duke përshtatur ngarkesën mësimore të studentëve. **[M3; M6]** **[Kapitulli I, Standardi III.7]**

5.8 Institucioni dhe Këshilli Studentor mbështetin një sërë veprimtarish sportive, kulturore dhe sociale, siç janë futbollit, volejbollit, fotografia dhe një klub arkeologjie, si edhe ekskursionet dhe ekspeditat. **[A1 fq.40; A27; A43; A49; M3; M6]** Studentët deklaruan se institucioni merr me qira një fushë futbollit, ka financuar një udhëtim në Maqedoni, dhe ka ofruar bileta për festën e Vitit të Ri. **[M3]** Studentët treguan se kanë mundësinë të angazhohen në punë në terren në lidhje me kurrikulën, për shembull përdorimi i pajisjes CPT; dhe se institucioni paguan për veshje të posaçme dhe transportin. **[M3]** Megjithëse studentët kanë një kartelë shëndetësore, ata theksuan se institucioni nuk ka një mjek në kampus. **[M3]** **[Kapitulli I, Standardi III.8]**

5.9 Strategjia e Zhvillimit të institucionit është tërësisht e orientuar drejt punësimit të ardhshëm të studentëve të tij. **[A4 fq.4]** Stafi dhe punonjësit pohuan se programet janë në përputhje me tregun e punës, **[M1a; M2; M4]** për shembull, me anë të realizimit të studimeve të tregut përpara hapjes së programeve të reja të studimeve. **[M2]** Zyra e Këshillimit të Karrierës mban të dhëna statistikore për punësimin e të diplomuarve të tij. Sipas të dhënave të fundit të alumni, që mbulojnë të gjithë të diplomuarit e institucionit deri më sot: nga 286 të diplomuar, 24 për qind prej tyre janë të punësuar në sektorin publik dhe 53 për qind në sektorin privat, ndërsa të tjerët janë të papunësuar. **[A22; M1a; M1b; M5]** Punëdhënësit me marrëveshje partneriteti me institucionin pohuan se ata rregullisht ofrojnë mundësi punësimi për studentët që kanë përfunduar praktikën profesionale në kompaninë e tyre. **[A1 fq.40; M4]** Institucioni ka punësuar disa të diplomuar në pozicione akademike dhe administrative me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. **[A1 fq.40; M3; M4]** Përpos kësaj, studentët kanë mundësinë për t'u angazhuar me inkubatorin e biznesit të institucionit për zhvillimin e ideve të biznesit (shihni pikën 4.6). **[Turi 2] [Kapitulli I, Standardi III.9]**

Gjetje**Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e dokumenteve

A. Dokumenti i vetëvlerësimit: Lista e dokumenteve

- Raporti i Vetëvlerësimit i IAL-së private Universiteti Metropolitan Tirana.pdf
Lista e anekseve.pdf
Aneksi 1 Statuti i UMT.pdf
Aneksi 2 Strategia e Zhvillimit të IAL-së private Universiteti Metropolitan Tirana.pdf
Aneksi 2.1 Vendimi i Senatit Akademik për vlerësimin e jashtëm të UMT.pdf
Aneksi 3 Rregullorja e brendshme e UMT.pdf
Aneksi 3.1 Rregullorja akademike.pdf
Aneksi 4 Letër MAS-it për miratimin e Statutit të ri dhe vendimet miratuese të organeve kolegjinale.pdf
Aneksi 5 Rregullorja e QVBC-së dhe Manuali i Cilësisë.pdf
Aneksi 6 Urdhër për ngritjen e grupeve të posaçme, për vlerësimin institucional dhe programet e studimeve.pdf
Aneksi 7 Një shembull i angazhimit të një eksperti për përmirësimin e një program studimi.pdf
Aneksi 8 Shembull – Raporti vjetor i UMT-së për veprimtarinë akademike.pdf
Aneksi 9 Dokument me informacione të përgjithshme për UMT.pdf
Aneksi 10 Shembull të përfundimeve të raportit të MAS-it për përmbushjen e kriterëve ligjore 2016-2017.pdf
Aneksi 11 Rregullorja e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Shkencave të Aplikuara.pdf
Aneksi 11.1 Rregullorja e departamentit.pdf
Aneksi 12 Shembull i procesverbaleve të mbledhjeve të departamentit dhe dokumentet shoqëruese.pdf
Aneksi 13 Kodi i Etikës.pdf
Aneksi 14 Shembull i studimit të tregut të punës për programet e studimit në Arkitekturë dhe Financë.pdf
Aneksi 15 Lista e veprimtarive të zhvilluara nga ZKK.pdf
Aneksi 15.1 Lista dhe axhenda e veprimtarive të Zyrës së Këshillimit të Karrierës në shkollat e mesme dhe Ditët Informuese në UMT.pdf
Aneksi 16 Lista e alumni (të dhëna statistikore).pdf
Aneksi 17 Lista e veprimtarive të realizuara me partnerë vendas dhe të huaj.pdf
Aneksi 18 Shembull i një Marrëveshjeje Partneriteti me Ekspertë të Huaj.pdf
Aneksi 18.1 Shembull i një Marrëveshjeje Partneriteti me SEC S.R.L.S. Romë.pdf
Aneksi 19 Lista e IAL-ve partnere, si vendase ashtu edhe të huaja.pdf
Aneksi 20 Lista e partneriteteve me institucione të tjera (joarsimore).pdf
Aneksi 21 Lista e pjesëmarrjeve të UMT-së në aktivitete ndërkombëtare.pdf
Aneksi 22 Shembull i aplikimit të projekti Erasmus +.pdf
Aneksi 23 Lista e stafit të huaj të ftuar.pdf
Aneksi 23.1 Kontratë tip me stafin e huaj me kohë të plotë.pdf
Aneksi 24 Udhëzime për Politikën e Rekrutimit dhe Procedurat e Stafit Akademik.pdf
Aneksi 24.1 Shembull i kriterëve për rekrutimin e stafit akademik dhe personelit administrativ.pdf
Aneksi 25 Shembull i shpalljes së vendeve të lira dhe i kriterëve të punësimit 2.pdf
Aneksi 26 Shembull i dosjes së aplikantit për punësim.pdf
Aneksi 27 Shembull i listës së kandidatëve të përzgjedhur për intervistë.pdf
Aneksi 28 Lista e stafit akademik që janë arsimuar në IAL të huaja.pdf
Aneksi 29 Shembull i mbështetjes financiare për pjesëmarrjen e stafit në konferenca, trajnime, etj .pdf
Aneksi 30 Stafi përfitues i granteve dhe shpërblimeve (në përqindje).pdf
Aneksi 31 Marrëveshja me Bibliotekën online “Mc Graw Hill” dhe faturat përkatëse.pdf
Aneksi 31.1 Lista e titujve të librave të bibliotekës “McGraw-Hill” dhe fotografi e ekranit të ndërfaqës së stafit dhe studentëve.pdf
Aneksi 31.2 Inventari i librave të bibliotekës.pdf

Aneksi 32 Lista e aktiviteteve sociale të organizuara nga stafi dhe studentët dhe fotografitë.pdf

Aneksi 33 Shembull i raportit për semestrin mbi vlerësimin e stafit në nivel fakulteti.pdf

Aneksi 34 Lista e stafit që ka përfituar nga rritja e rrogës ose ngritja në pozicion (në përqindje).pdf

Aneksi 35 Shembull i Kontratës Individuale të Punës.pdf

Aneksi 36 Lista e projekteve të cilat ka aplikuar UMT dhe qendra "Metroresearch".pdf

Aneksi 36.1 Raporti Vjetor i qendrës Metroresearch.pdf

Aneksi 37 Lista e projekteve sociale të realizuara nga studentët dhe stafi dhe fotografitë.pdf

Aneksi 38 Rregullorja e menaxhimit financiar dhe kontrollit të financave.pdf

Aneksi 39 Rregullorja e programit të dixhitalizimit online të sekretarisë mësimore dhe sistemit të financës.pdf

Aneksi 40 Foto e ekranit të kompjuterit të sistemit SISI, Faqja e internetit, Portali i studentëve, AMS, Rrjetëzimi social, portale të tjera.pdf

Aneksi 41 Lista e laboratorëve të UMT.pdf

Aneksi 42 Lista e portaleve elektronike dhe fotografi të ekranit.pdf

Aneksi 42.1 Prezantimi i Metropolitan Incubator në fushën e TIK.pdf

Aneksi 42.2 Informacion për investimet të Metropolitan Incubator.pdf

Aneksi 43 Lista e projekteve në fushën e TIK dhe MI dhe fotografi e ekranit të Ciceronit Virtual.pdf

Aneksi 44 Kontratat e qirasë për ambientet dhe planimetritë.pdf

Aneksi 45 Rregullorja për mbajtjen dhe administrimin e të dhënave dhe informacionit nga Zyra e Arkivit dhe Protokollit të IAL-së private, universiteti Metropolitan Tirana.pdf

Aneksi 46 Shembull i arkivimit të projektit "Ciceroni Virtual".pdf

Aneksi 47 Përshkrimi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në portal dhe fotografi e ekranit.pdf

Aneksi 48 Shembull i zhvillimit të kursit të matematikës për maturantët.pdf

Aneksi 49 Lejet higjieno-sanitare dhe certifikatat për mbrojtjen nga zjarri.pdf

Aneksi 50 Projekti + plani për kampusin e ri.pdf

Aneksi 51 Shembull i miratimit të kriterëve dhe kuotave të pranimit.pdf

Aneksi 52 Praktikë e plotë në KVIPP.pdf

Aneksi 53 Shembull i ngarkesës mësimore të stafit akademik.pdf

Aneksi 54 Kontratë tip për stafin akademik.pdf

Aneksi 55 Akte rregullatore për ngarkesën akademike.pdf

Evidenca 56.1 Shembull program studimi i Ciklit I dhe Ciklit II FISHA.pdf

Evidenca 56.2 Shembull program studimi i Ciklit I dhe Ciklit II FE.pdf

Aneksi 57 Udhëzues për Vlerësimin dhe Transferimin e Studimeve në IAL-në private UMT.pdf

Aneksi 58 Shembull i pyetësorë të QVB, një shembull i analizës së pyetësorëve.pdf

Aneksi 59 Rregullore për praktikën profesionale.pdf

Aneksi 60 Rregullore për diplomimin.pdf

Aneksi 61 Praktikat profesionale në punët e inxhinierisë.pdf

Aneksi 62 Kalendar akademik dhe orari për vitin akademik 2016-2017.pdf

Aneksi 63 Rregullore për provimet.pdf

Aneksi 64 Shembull i një teze provimi, i një model të tezës së diplomës, i fletë prezencës dhe detyrave të kursit.pdf

Aneksi 65 Raport për realizimin e punës individuale kërkimore shkencore.pdf

Aneksi 66 Lista e botimeve shkencore të UMT.pdf

Aneksi 66.1 Lista e artikujve shkencorë të botuar nga stafi akademik.pdf

Aneksi 67 CV-të e stafit të huaj akademik.pdf

Aneksi 68 Lista e temave të diplomës për ciklin e dytë.pdf

Aneksi 68.1 Shembull i diplomës së ciklit të dytë.pdf

Aneksi 69 Rregullorja e Këshillit Studentor.pdf

Aneksi 70 Lista e tutorëve akademikë dhe grupeve përkatëse.pdf

Aneksi 70.1 Kalendar i mbledhjeve periodike të studentëve me stafin akademik dhe drejtuesit e UMT.pdf

Aneksi 71 Lista e shembujve të broshurave informuese të UMT.pdf
Aneksi 72 Programi i bursave 2016-2017.pdf
Aneksi 72.1 Lista e bursave të dhëna në shkollat e mesme 2016-2017.pdf
Raport i Vetëvlerësimit Institucional SHPAL Universiteti Metropolitan Tirana.pdf

B. Lista e dokumenteve shtesë gjatë fazës së vlerësimit të dokumentacionit

B.1 Lista e dokumenteve të tjera.pdf
B.2 Relacion për dokumente shtesë.pdf
B.3 [Evidenca 1] Shembuj të Manualeve të Studentëve për secilin nga ciklet e studimit.Alb.pdf
B.4 [Evidenca 2] Shembuj të specifikimeve të programeve për çdo cikël studimi. Eng.pdf
B.5 [Evidenca 3] Dokumenti i zhvillimit të programeve të reja ose atyre ekzistuese në përgjigje të kërkesës së tregut të punës (p.sh. përgjigja ndaj kërimit të tregut).Eng.pdf
B.6 [Evidenca 4] Të dhënat statistikore për punësimin e studentëve sipas programit të studimit. Eng.pdf
[Evidenca 5] Reagimi i punëdhënësve ose udhëheqësve për praktikën e detyrueshme profesionale të studentëve.Eng-Alb.pdf
B.7 [Evidenca 6] Një shembull i dokumentacionit në lidhje me ankesën e një studenti (anonim) dhe ankimimin e një studenti dhe si u zgjidhën ankesa dhe ankimimi. Eng.pdf
B.8 [Evidenca 7] Procedurat e ankesave dhe ankimimit.Eng.pdf
B.9 [Evidenca 8] Politika e Vlerësimit të Performancës Individuale dhe shembulli i një anëtari anonim të stafit. Eng-Alb.pdf
B.10 [Evidenca 9] Tre shembuj të formularëve të brendshëm të plotësuar të anketimeve për studentët që të japin feedback-un e tyre Alb.pdf
B.11 [Evidenca 10] Tre shembuj të formularëve të monitorimit të vlerësimit të tezave të përfunduara të diplomës Eng-Alb.pdf
B.13 [Evidenca 11] Lista e stafit akademik sipas departamentit; numri i studentëve sipas programeve të studimit.Eng.pdf
B.14 [Evidenca 12] Politika e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional.pdf
B.15 [Evidenca 13] Politika e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional. (Statuti i UMT, neni 4). Eng.pdf
B.16 [Evidenca 14] Listat e stafit akademik sipas departamentit që merr pjesë në projektet e financuara nga universiteti Eng.pdf
B.17 [Evidenca 15] Lista e botimeve të stafit akademik nga projekte kërkimore aktuale dhe të përfunduara.Eng.pdf
B.18 [Evidenca 16] Dokumente që paraqesin se si departamentet e kërkimit dhe inkubatori i biznesit kontribuojnë në kërkimin shkencor të universitetit.Eng.pdf
B.19 [Evidenca 17] Një shembull i vlerësimit periodik të veprimtarisë kërkimore Eng.pdf
B.20 [Evidenca 18] Politika për aftësinë e kufizuar.Eng.pdf
B.21 [Evidenca 19] Lista e bursave të dhëna çdo vit, duke sqaruar kategoritë e synuara të studentëve dhe/ose për arsye specializimi. Eng.pdf
B.22 [Evidenca 20] Lista e Ditëve të Hapura dhe vizita të kolegjet nga vijnë studentët më të shumtë. Eng.pdf
B.23 [Evidenca 21] Lista e klubeve studentore, shoqatave, veprimtarive dhe aktiviteteve sportive Eng.pdf
B.24 [Evidenca 22] Evidenca se si mirëpritën dhe integrohen në institucion studentët e rinj (duke përfshirë studentët e huaj). Eng.pdf
B.25 [Evidenca 23] Numri dhe destinacionet e stafit dhe studentëve që kanë kryer punë studimore jashtë vendit. Eng.pdf
B.26 [Evidenca 24] Raporti Vjetor i Shërbimeve Mbështetëse Eng.pdf
B.27 [Evidenca 25] Politikat për orientimin dhe udhëzimin e studentëve. Eng.pdf, Rregullorja e Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Eng.pdf
B.28 [Evidenca 26.1] Procesverbalet e diskutimeve të mbledhjeve të komisionit për zhvillimin e kampusit të ri.Eng.pdf

- B.29 [Evidenca 26.2] Procesverbalet e diskutimeve të mbledhjeve të komisionit për anketimet e brendshme të studentëve. Eng.pdf
- B.30 [Evidenca 26.3] Procesverbalet e diskutimeve të mbledhjeve të komisionit për planifikimin e ngarkesës mësimore dhe se si bëhet shpërndarja për punë kërkimore. Eng.pdf
- B.31 [Evidenca 26.4] Procesverbalet e diskutimeve të mbledhjeve të komisionit për zhvillimin e programeve të reja Eng.pdf
- B.32 [Evidenca 26.5] Procesverbalet e diskutimeve të mbledhjeve të komisionit për Raportin vjetor 2015-2016 dhe prioritetet e kërkimit, planifikimit dhe vlerësimit Eng.pdf
- B.33 [Evidenca 26.6] Procesverbalet e diskutimeve të mbledhjeve të komisionit për të dhënat e performancës së studentëve Eng.pdf

C. Lista e dokumenteve shtesë të shqyrtuara gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm

- C.1 Aktivitete në kuadër të trajnimit të stafit.pdf
- C.2 Aktivitete sociale 2016-2017.pdf
- C.3 Buxheti 2016 - 2017 - fondet për kërkimin shkencor.pdf
- C.4 Kuotat dhe kriteret e pranimit të publikuara në web - Printscreens.pdf
- C.5 Ngritja e KVP dhe shembull i procesverbalit.pdf
- C.6 Udhëzues mbi rekrutimet e stafit administrativ (politikat).pdf
- C.7 Akt Themelimi dhe Statuti i InSitu Balkans (CPT) dhe Marrëveshja e Bashkëpunimit.pdf
- C.8 Akt Themelimi dhe Statuti i METRORESEARCH NGO.pdf
- C.9 Lista e Kurseve të të nxënësve gjatë gjithë jetës.pdf
- C.10 Meth & Tech për mësimdhënien dhe sigurinë e informacionit.pdf
- C.11 Vlerësimi i performancës së personelit administrativ.pdf
- C.12 Relacioni teknik për vlerësim e ndërtesave të UMT.pdf
- C.13 Studimi i Tregut për programet e studimit Master në Arkitekturë me profilet.pdf
- C.14 Relacionet e tezave të diplomës së Masterit që kanë përfshirë kërkimin shkencor (6 shembuj).pdf
- C.15 Plani veprimi për qendrën Metroresearch.pdf
- C.16 Lista e Anekseve mbështetëse për UMT 6-7_7_17.pdf

D. Lista e dokumenteve të siguruar nga APAAL-i

Anketimi i studentëve
Anketimi i stafit akademik

E. Lista e mbledhjeve dhe turet

Mbledhjet

- M1a Rektori
- M1b Grupi i Vetëvlerësimit
- M2 Personel Mbështetës
- M3 Studentët
- Turi 1 Dy ndërtesa të Qyteti të Studentit
- M4 Punëdhënësit dhe Partnerët
- M5 Stafi Akademik
- M6 Personel Mbështetës
- Turi 2 Ndërtesa e inkubatorit